




REPUBLIKA E KOSOVES, REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr Prot 01-2095/20
Dep. 02	Bi Prot
Nr. flet. 02	Prot No
Broj stranica	Datim 13.06.2012
Nr. pages	Dat



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika d)si dhe 29.3 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.05.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr. AKK– 03-5096/11, për, **z.Elvis Pista, Këshilltar Politik ne Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale**, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt te interesit me numër protokolli, AKK– 03-5096/11, që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë z.Elvis Pista, Këshilltar Politik ne Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Pas zhvillimit të procedurës, dhe analizimit te gjendjes te dyshuar për konflikt te mundshëm te Interesit si dhe mos pajtueshmëri ne Ushtrimit e Funksionit Publik. Agjencia Kundër korrupsionit ka ndërmarre te gjitha veprimet nevojshme ligjore.

Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar z.Pista me shkresën e dërguar tek ai, se është ne procedurë te shqyrtimit te gjendjes se mundshme te konfliktit te interesit ne ushtrimin e funksionit publik si dhe, ka komunikuar me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale për te marre informata shtesë dhe për te vërtetuar gjendjen reale.

Më datën 19.04.2012 zyrtaret e Agjencisë kane qene ne takim ne zyrat e PTK ku z.Pista mban pozitën e UD-të Sekretarit te Korporatës, ku janë njoftuar nga për gjendjen faktike si dhe për funksionin aktual qe ushtron z.Pista, si dhe është sqaruar nga ai se nuk është ne marrëdhënie pune me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe nuk paguhet nga kjo Ministri qe nga 28.02.2011.

Bazuar nga faktet dhe gjendja reale konstatojmë se z.Elvis Pista, nuk është me ne marrëdhënie pune me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe nuk ka të dhëna të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e gjendjes së konfliktit të interesit, në këtë periudhë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtör i Agjencisë kundër Korrupsionit

